



Pranuar / Dorezuar Prilbena / Profuturo Received / Delivery	01.02.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. Unit	Nr Prot Ri Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/SHCK	468/2022		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1018/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi BAJRAKTARI, anëtar, si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1018/2021 të datës 07.12.2021 e parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat ne adresë Komuna e Prishtinë, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 01.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e jashtëafatshme ankesa me numër A.nr.1018/2021 e datës 07.12.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 07.12.2021 ka parashtruar ankesë nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar Avokat ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 5856/2021 kundër heshtjes administrative të Komisionit për Grada dhe Disiplinë në lidhje me kërkesën e dt. 08.09.2021 dhe Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm-Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në lidhje me kërkesën e dt. 02.09.2021.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.01.2022 merr vendimin VK.nr. 01/2022 me të cilin vendim është bërë vazhdimi i afatit për vendosje për dhjetë (10) ditë pune për ankesën e ankuesit

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 13.12.2021 ka kërkuar përgjigje në ankesën e

ankuesit nga Ministria e Punës të Jashtme dhe Diasporës. Këshilli më datë 21.12.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/15.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Vendimi i datës 18.01.2022 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e ankuesit e datës 07.12.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi për përfaqësim i datës 03.12.2021; Vendimi i datës 02.03.2017 i Ministrit të Punëve të Jashtme; Vendimi i datës 01.10.2021 i Zv. Sekretares së Përgjithshme; E-mail-at e datave 08.09.2021, 13.08.2021; Shprehje interesi për pozitën vakante në mision diplomatik/konsullor të Republikës së Kosovës e ankuesit e datës 02.09.2021; Kërkesa për gradim, gjegjësisht ngritjes të gradës Diplomatike e datës 08.09.2021; Formulari i vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2019, 2018; CV e ankuesit; Certifikata e datës 16.02.2018; Certifikata e datës 18-19-20 shtator 2017; Akt emërimi i ankuesit i datës 07.04.2021; Vendimi me nr.të ref.77/2021 i Zv. Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimi i datës 16.02.2021 i Ministres në Detyrë e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Vendim me nr.ref.114/2021 i Zv. Sekretarit të Përgjithshëm si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës 1/15.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjes e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e *jashtëafatshme, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, nga provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi me datë 02.09.2021 ka parashtruar kërkesë tek kryesuesi i Komisionit/MPJD dhe me datë 08.09.2021 ka parashtruar kërkesë te Komisioni për Grada dhe Disiplinë me pretendim për shprehje të interesimit për pozitat vakante në misione diplomatike/konsullore të Republikës së Kosovës.

Ankuesi pasi që nuk merr përgjigje lidhur me kërkesën e tij të datës 08.09.2021 dhe të datës 02.09.2021 me datë 07.12.2021 parashtron ankesë nëpërmjet përfaqësuesit të tij me numër të protokollit 5856/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendim *"kundër heshtjes administrative të Komisionit për Grada dhe Disiplinë në lidhje me kërkesën e dt. 08.09.2021 dhe Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm-Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në lidhje me Kërkesën e dt. 02.09.2021"*.

Me dispozitat e nenit 127 paragrafi 4 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton se: *"4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"*. Kolegji për shqyrtimin e ankesave në bazë të dëshmive të ofruara ka konstatuar se ankuesi me datë 08.09.2021 te Komisioni për Grada dhe Disiplinë dhe të kërkesës së datës 02.09.2021 ka parashtruar kërkesë tek kryesuesi i Komisionit/MPJD me pretendim për shprehje të interesimit për pozitat vakante në misione diplomatike/ konsullore të Republikës së Kosovës, ndërsa ankesën me numër protokollit 5856/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka parashtruar me datën 07.12.2021, andaj Kolegji vlerëson se parashtrimi i ankesës nga ankuesi me datë 07.12.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127

paragrafin 1 dhe 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: „Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ” si dhe 4 „Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ”.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1018/2021, datë 01/02/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Menaxheres së Personelit në Ministrinë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

